EKSTRAKT NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË KONTRATËS SË SIGURIMIT JETA E NXËNËSVE DHE STUDENTËVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jeta e Nxënësve & Studenteve është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në mënyrën dhe masën e parashikuar në këtë kontratë, nëse ndodh të vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1. Përcaktime

1.1.1. Përcaktime të Përgjithshme

a) Kushtet e përgjithshme të kontratës për sigurimin e Jetës së nxënësve dhe studentëve do të quhen "**Kushtet e Sigurimit**".
b) Kompania e Sigurimit "SiCRED" sh.a. do të quhet "**Siguruesi**".
c) Personi fizik, në emër të të cilit do të lidhet polica e Sigurimit dhe që në momentin e lidhjes se saj ndjek shkollën me shkëputje nga puna, do të quhet "**I Siguruari**".
d) Personi fizik ose juridik i cili nënshkruan kontratën e sigurimit, do të quhet "**Kontraktuesi**".
e) Dokumenti që provon dhe rregullon kontratën për sigurimin e nxënësve dhe studentëve, do të quhet "**Polica e Sigurimit**".
f) Personi fizik apo juridik që përfiton nga polica e sigurimit në bazë të vullnetit të shprehur në këtë policë nga i siguruari, do të quhet "**Përfituesi**".
g) Shuma që i siguruari i paguan siguruesit për të blerë policën e sigurimit do të quhet "**Prim i Sigurimit**".
h) Vlefta në të holla që SiCRED i detyrohet të siguruarit ose përfituesit, masa e të cilës përcaktohet në këtë policë sigurimi, do të quhet "**Përfitim**".

1.1.2. Përcaktime të Veçanta

a) **Aksident** do të quajmë çdo ngjarje që ndodh për shkak rastësor, të dhunshëm dhe të jashtëm, i cili shkakton dëmtime fizike objektivisht të vërtetueshme, si pasojë e të cilave mund të vërtetohet paaftësia e përkohshme, e përhershme ose vdekja.

b) **Sëmundje kritike** për efekt të mbulimit në sigurim, sëmundje kritike do të konsiderohen shfaqja apo diagnostikimi brenda periudhës së sigurimit së marrjes në sigurim me kusht që të mos jenë të njohura dhe identifikuara para lidhjes së policës së sigurimit të njërës:

I. ataku i zemrës;
II. goditja cerebrale;
III. kirurgjia e arterevе koronare;
IV. kanceri;
V. dëmtimi i një ose dy veshkave;
VI. paraliza e të dy këmbeve;

c) **Paaftësi e përhershme** është humbje e plotë anatomike ose funksionale e gjymtyrëve ose organeve që vjen si pasojë e dëmtimeve aksidentale. Paaftësia e përhershme që vjen si pasojë e një sëmundjeje nuk është e pagueshme nga Siguruesi.

d) **Paaftësi e përkohshme** për efekt sigurimi, do të kuptohet një dëmtim i të Siguruarit si pasojë e aksidentit ku për një periudhë prej disa ditore dhe me vërtetim të mjekut kurues, i siguruari nuk është i aftë të frekuentojë mësimet. Për efekt të këtij sigurimi, ditët e shkollës llogariten duke përjashtuar ditët e diela dhe ditët e pushimit të shkollës.

e) **Humbje e dëgjimit, aftësisë për të folur, të parit** do të konsiderohet humbja totale dhe e përhershme e dëgjimit, e aftësisë për të folur dhe e të parit, do të konsider humbje që shkaktohet si pasojë e një aksidenti.

f) **Shpenzimet mjekësore dhe të udhëtimit**. Në qoftë se i siguruari si rezultat i një aksidenti, ka nevojë për ndihmë mjekësore të specializuar brenda apo jashtë vendit dhe kur një gjë e tillë konfirmohet nga një autoritet mjekësor kompetent, Siguruesi merr përsipër rimbursimin e shpenzimeve të kryera nga i Siguruari për trajtim mjekësor dhe udhëtim deri në shumën e sigurimit. Në qoftë se, me gjithë ndihmën e specializuar të dhënë i Siguruari vdes, atëherë Siguruesi paguan shumën e sigurimit të shprehur në policë pasi janë zbritur përfitimet e paguara deri në këtë moment.

g) **Frakturë** Për efekte të mbulimit në sigurim, frakturë do të quhet thyerje e një apo më shumë kockave të shkaktuara nga aksidenti si pasojë tek i aksidentuari vërtetohet humbja e aftësisë së përkohshme apo të përhershme.

1.2. E drejta për t'u Siguruar

a) Kanë të drejtë të Sigurohen te gjithë nxënësit dhe studentët që kryejnë studimet e tyre brenda Republikës së Shqipërisë dhe me shkëputje nga puna.

b) Nuk sigurohen, personat që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi ose sëmundjet mendore si skizofrenia, format maniako-depresive e gjendjet paranojake apo sindroma organike cerebrale. Gjithashtu nuk sigurohen personat që kërkojnë kujdes të përhershëm mjekësor. Do të konsiderohen të tillë personat që e mbështesin jetesën dhe nevojat e përditshme tek ndihma e kujdesi i të tjerëve.

1.3 Përfitime të Pagueshme

Sigurimi i Jetës, së Nxënësve dhe Studentëve mbulon:

c) Rrezikun e humbjes së Jetës së të siguruarit.

d) Rrezikun e shfaqjes së Sëmundjeve Kritike

e) Aksidentet që pëson i siguruari gjatë periudhës së Sigurimit të cilat konsistojnë me dëmtime trupore dhe që shkaktojnë humbjen e Jetës, paaftësinë e përkohshme apo të përhershme tek i aksidentuari.

1.4 RREZIQE TË PËRJASHTUARA

Nuk mbulohen nga ky sigurim, aksidentet personale apo vdekja për shkak të:

1. ndërhyrjeve kirurgjikale, kontrolleve apo kurimit për pasoja që nuk lidhen me kushtet e kësaj police sigurimi;
2. akteve të kryera me dashje ose të tentuara nga i Siguruari;
3. dehjes, përdorimit të tepruar të psikofarmaceutikëve, të drogës ose të haluçinantëve;
4. operacioneve luftarake, zhvillimit të kryengritjeve, zhvendosjeve të tokës e shpërthimeve vullkanike;
5. shpërthimeve dhe radiacionit të energjisë bërthamore, pavarësisht nga origjina e shkaktimit të tyre;
6. pjesëmarrjes së Kontraktuesit dhe Përfituesit në krime me dashje ndaj të Siguruarit;
7. çdo dëmtimi që vjen si shkak i:
    - vetëvrasjes, tentativës për vetëvrasje ose vetëdëmtim i qëllimshëm
    - shtatzënisë, lindjes apo abortimit.
8. çdo defekti fizik, çrregullimi kushtesh mjekësore të caktuara ose kronike ose sëmundje të cilat kanë ekzistuar që më parë, përveç rasteve kur ajo na është bërë e ditur dhe ne kemi dhënë aprovimin me shkrim.
9. dëmtimit apo sëmundjes për shkak të infektimit masiv pandemik dhe bioterrorizmit.

1.4. Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

1. I Siguruari ose Përfituesi, për marrjen e dëmshpërblimit, i paraqet Siguruesit kërkesë me shkrim, e cila duhet të tregojë edhe emrin e të Siguruarit, numrin dhe datën e policës së sigurimit.

I Siguruari ose i interesuari duhet të paraqesë këto dokumente sipas rasteve të poshtëshënuara:

a) Në rast vdekje:

I. Kontratën e sigurimit;
II. Çertifikatën e vdekjes;
III. Skedën e vdekjes, e cila firmoset nga mjeku ligjor i rrethit;
IV. Vendimin gjyqësor për trashëgiminë, kur përfituesi nuk është shënuar në policën e sigurimit;
V. Vërtetim nga prokuroria në lidhje me ngjarjen (nëse vdekja është aksidentale-ky dokument do të paraqitet vetëm në rastet kur gjykohet e domosdoshme për t'u paraqitur nga siguruesi).

b) Në rast paaftësie të përhershme ose të përkohshme:

I. Kontratën e sigurimit;
II. Çertifikatën mjekësore, e cila plotësohet nga mjeku kurues;
III. Ekspertizën mjekësore;
IV. Raportet mjekësore;

2. Në çdo rast, i Siguruari është i detyruar të paraqesë dokumenta të tjerë plotësues sipas kërkesës së Siguruesit.
3. Dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

1.5 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.